



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për:	Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës Rrahim Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MPL-së	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Data: 04.08.2020 Nr.020-558
Zyrtaret përgjegjës:		
1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Malishevës	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim i Kuvendit të Komunës për emërimin e dy anëtarëve në komitetin për politikë dhe financa nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë.
I miratuar më datë:30.07.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 04.08.2020


Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

Nr.	Formulimi në aktin e komunës	Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim
1.	Vendim i Kuvendit të Komunës për emërimin e dy anëtarëve në komitetin për politikë dhe financa nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë.	Ky vendim nuk është në përputhje me Ligjin Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, nenin 6, paragrafin 7 dhe 8, ku parashihet se: "Organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse". Gjithashtu, Ministria e Pushteti Lokal dhe Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, më datë 18.12.2017, ka dërguar një shkresë shpjeguese në komuna lidhur me respektimin e Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Pushtetit Lokal, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Malishevës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samoprave
Ministry of Local Government

Za :	Ragip Begaj , gradonačelnik opštine Mališevo, Rrahim Morina , predsedavajući Skupštine opštine Mališevo
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini
Preko:	Goran Rakić , zamenik premijera i ministar MLS Rozafa Ukimeraj , generalna sekretarka MLS
Od:	Venera Qerkini , rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština/ MLS
Odgovorni službenici:	Xhevat Tafa , rukovodilac Odseka za monitorisanje opština
1.Službenik za utvrđivanje zakonske procene	
2.Službenik-ca za izradu zakonske procene	Ardita Latifi , viša službenica za monitorisanje opština
Predmet:	Zahtev za reviziju zakonitosti akta opštine Mališevo
Vrsta akta:	☐ Odluka Skupštine opštine

Datum,
04.08.2020.
br. 020-558

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.06/2020 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstva, Ministarstvo lokalne samouprave primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine, kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka Skupštine opštine o imenovanju dva člana komiteta za politiku i finansije iz redova Socijaldemokratske inicijative u Mališevu.

Usvojena dana, 30.07.2020. godine,

Predložena za razmatranje u MLS, dana, 04.08.2020. godine,

Ministarstvo lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ocenilo je da je, opštinski akt u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

Br.	Formulisane u opštinskom aktu	Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti.
1.	Odluka Skupštine opštine o imenovanju dva člana odbora za politiku i finansije iz redova Socijaldemokratske inicijative u Mališevu.	Ova odluka nije u skladu sa Zakonom br. 05 / L-020 o rodnoj ravnopravnosti, član 6. stav 7. i 8. koji predviđa: „Zakonodavna, izvršna i sudska tela na svim nivoima, kao i druge javne institucije, dužna su da usvoje i sprovede posebne mere za postizanje zastupljenosti manje zastupljenog pola, do postizanja ravnopravne zastupljenosti žena i muškaraca u skladu sa ovim zakonom. Jednaka rodna zastupljenost u svim zakonodavnim, izvršnim i pravosudnim telima i drugim javnim institucijama postiže se kada je za svaki pol obezbeđena minimalna zastupljenost od pedeset posto (50%), uključujući njihova tela upravljanja i tela koja donose odluke”. Takođe, Ministarstvo lokalne samouprave i Agencija za ravnopravnost polova u okviru kabineta premijera, datuma 18.12.2017.godine, dostavilo je opštinama pismo objašnjenja u vezi sa poštovanjem zakona br. 05 / L-020 o rodnoj ravnopravnosti.

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo lokalne samouprave **zahteva** od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine, preduzimanje konkretnih mera, kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva za reviziju akta.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Ministria e Administratës së Përbashkët Lokale Ministry of Local Government Administration	
Data	04.08.2020
Shënim	
Numërtim	02-02-558

Kuvendi i Komunës
Nr. 02/273
Datë: 04.08.2020

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pike d, nenit 52 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 5 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, në bazë të nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 shkronja f, nenin 26 dhe 27, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë: 12.11.2008, kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -II- (dytë) të jashtëzakonshme të mbajtur me datë: 30.07.2020 merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E DY ANËTAREVE NË KOMITETIN PËR POLITIKË DHE FINANCA
NGA RADHËT E NISMËS SOCIALDEMOKRATE NË MALISHEVË

1. Miratohet kërkesa nr.02/256 datë:17.07.2020 e parashtruar nga shefi i Grupit të anëtarëve në Kuvendin e Komunës së Malishevës nga radhët e Nismës Socialdemokrate për emërimin e dy anëtarëve në Komitetin për Politikë dhe Financa.
2. Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi dy anëtarët e emëruar në Komitetin për Politikë dhe Financa nga radhët e Nismës Socialdemokrate janë:
 - 2.1. Filloreta Bytyçi anëtare - Nisma Socialdemokrate
 - 2.2. Halil Morina anëtar - Nisma Socialdemokrate
3. Ky vendim do të jetë pesë përbërëse e vendimit nr.02/14 datë:05.02.2018, për themelimin-emërimin e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Malishevës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës përmes kryesuesit të Kuvendit.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Anëtarëve të Komitetit.

Kryesuesi i Kuvendit
Halil Morina



Për : Kryesuesin e Kuvendit Komunal Malisheve Rrahim Morina

Nga: Sylë Dukolli ,shef i grupit të Asambleistëve Nisma socialdemokrate Malisheve

Lënda : Kerkese per marrjen e mandateve ne komitete .

Data: 16/07/2020

17/07/2020

02/256

I nderuari Kryesues z.Morina ,

Ju njoftoj se pas lirimt të vendit të shefit te grupit të asambleistëve të Nismës nga Arbersha Krasniqi,tani m me vullnetin e asambleistëve te Nismës unë Sylë Dukolli do jemi përfaqësues /shef i tyre ne Kuvend .

Neve si grup jemi dakorduar që të marrim te gjitha mandatet që na takojnë ne Komitete ,e di me situatën qe neve si grup patëm kërkuar te na ndahen komitetet sipas marrjes se përqindjes ne zgjedhje ,por hasem ne mos mirëkuptim,prandaj sot kërkojmë pjesëmarrjen ne komitete sipas propozimt qe ka dal ne ditën e propozuar nga ju ne Kuvend ,pra 2 antarë ne KPF e kështu me radh ne komitete tjera.

Duke u bazuar ne te drejtën tone ,kërkojmë futjen ne te gjitha komitetet qe i parashef rregullorja e Kuvendit Komunal Malishevë.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 05.02.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika d, neni 51 paragrafi 1, nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e hemelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme në Komunë, në bazë të nenit 19 paragrafi 7 shkronja f, nenin 26 paragrafi 1 shkronja a, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 31.01.2018 mori këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

1. Miratohet vendimi për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Malishevës.
2. Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa do të jetë prej 7 anëtarëve;
 1. Rrahim Morina nga radhët e LDK-së, Kryesues
 2. Valon Krasniqi nga radhët e LDK-së
 3. nga radhët e Nisma Socialdemokrate
 4. nga radhët e Nisma Socialdemokrate
 5. Hashim Vrenezi nga radhët e PDK-së
 6. Raimonda Krasniqi nga radhët e PDK-së
 7. Alban Krasniqi nga radhët e VV-së
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komitetit për Politikë dhe Financa janë të përcaktuara me nenin 52 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë 12.11.2008, dhe akteve tjera nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, zgjatë njëjtë sa mandati i rregullt ligjor i Kuvendit të Komunës së Malishevës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e artimit dhe publikimit të Akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;
Arkivit të Komunës
MAPL-së.



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina

RECORDING
KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
FEDERAL GOVERNMENT OF KOSOVO
Ministry of Administration and Local Government
05-02-2018
-11- 020-172